

# POLITIKA E MBROJTJES E TË DHËNAVE

## Për kë aplikohet politika e mbrojtjes së të dhënave?

Punonjësit e kompanisë sonë dhe ndarjet e grupit duhet të ndjekin këtë politikë. Partnerët e biznesit, konsulentët si dhe gjithë entitetet e jashtme janë të përfshira në këtë politikë.

Përgjithësisht politika jonë i referohet cilido që ne bashkëpunojmë ose që vepron në emrin tonë dhe që i nevojitet akses në të dhëna.

## Politika dhe kuadri i saj

Si rrjedhojë e proceseve të biznesit tonë nevojitet të marrim dhe përpunojmë informacion të ndryshëm. Ky informacion përfshin të dhëna online dhe jo vetëm që shërben për të identifikuar një person ndër të tjera si emrat, adresat, emer përdoruesi, fjalëkalime, prezencë dixhitale, fotografi, numer ID, të dhëna financiare, etj.

Ne dhe kompania jonë e mbledh këtë informacion nëpërmjet metodash transparente dhe vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të plotë dhe dijenisë së palëve të interesuara. Nga momenti që ky informacion mblidhet prej nesh, aplikohen rregullat e mëposhtme. Të dhënat tona do të jenë:

- Të sakta dhe mbajtura sa me të përditesuara.
- Të mbledhura në mënyrë të drejtë dhe vetëm për qëllime ligjore.
- Të përpunuara nga kompania jonë brenda kuadrit ligjor dhe moral.
- Të mbrojtura kundër çdo aksesit të pa autorizuar, apo të paligjshëm nga palët e brendshme dhe të jashtme.

Të dhënat tona nuk do të:

- Komunikohen në mënyre informale.
- Ruhen për periudhë mbi atë të përcaktuar.
- Transferohen në organizata, shtete apo vende të cilët nuk kanë politika të përshtatshme të mbrojtjes së të dhënave.
- Shpërndahen në një entitet përtej atyre të dakortëzuara nga poseduesi i të dhënave (me përjashtimin e kërkesave legjitime nga autoritetet ligj zbatuese).

Përtej metodave si do të menaxhohen të dhënat, kompania ka detyrim direkt drejt personave që u përkasin të dhënat. Specifikisht ne duhet të:

- Informojmë personat për, cilat nga të dhënat jemi duke mbledhur.
- Informojmë personat si do ti përpunojmë këto të dhëna.
- Informojmë në lidhje me cilët persona kanë akses tek informacioni i mbledhur.
- Kemi hapa konkrete për të dhëna që humbasin, degradojnë apo që janë kompromentuar.
- Lejojmë personat të kërkojnë që ne të modifikojmë, fshijmë, reduktojmë apo korigjojmë të dhënat që ndodhen në databazat tona.

## **Veprimet:**

Në mënyrë që të zbatohet mbrojtja e të dhënave në përkushtohemi që të:

- Kufizojmë dhe monitorojmë aksesin ndaj të dhënave sensitive.
- Zhvillojmë procedura transparente të mbledhjes së të dhënave.
- Trajtojmë punonjësit për privacinë online dhe metodave të sigurisë.
- Ndërtojmë rrjete të sigurta për të mbrojtur të dhënat online nga sulmet kibernetike.
- Aplikojmë procedura të qarta për të raportuar çënime të privatësisë apo keq përdorimit të të dhënave.
- Përfshijmë elemente kontraktual apo komunikojmë si do të menaxhojmë të dhënat.
- Përdorim praktika e mbrojtjes së të dhënave (shkatërrim dokumentash, çelësa të sigurtë, enkriptim të dhënash, backup të shpeshtë, autorizim aksesit, etj).
- Politika e mbrojtjes së të dhënave do të shfaqet në faqen tonë zyrtare.

## **Rrjedhoje e kësaj politike**

Të gjitha parimet në këtë politike duhet të ndiqen në mënyrë rigorozë. Një çënim i parimeve të mbrojtjes së të dhënave do të shkaktojë një veprim disiplinor dhe mundësisht ligjor.